

VENDIM
Nr.560, datë 2.12.1999

PËR KRIJIMIN E FONDACIONIT “FONDACIONI I FINANCIMIT PËR ZONAT MALORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 54 dhe 63, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.207, datë 28.4.1999, “Për ndarjen dhe ristrukturimin institucional të Fondit të Zhvillimit Shqiptar”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Krijimin e fondacionit “Fondacioni i financimit për zonat malore”, si institucion për kreditimin e fermave, që, nga ana financiare, janë të qëndrueshme dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve rurale, në zonat malore të vendit. Veprimtaria e këtij fondacioni të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statusin, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondet dhe astet e FKF-ve në projektin e zhvillimit rural të rretheve verilindore (PZHRRrVl), që, sotpërsot, administrohen nga “Fondi i financimit rural”, të transferohen, në formë granti, në “Fondin e financimit për zonat malore”, sipas marrëveshjes që do të lidhet për këtë qëllim ndërmjet Ministrisë së Financave, “Fondit të financimit rural”, dhe “Fondit të financimit për zonat malore.”.

3.Fondet e huave, që kanë mbetur në dispozicion sipas aneksit 2, kategoria 3, të marrëveshjes së ndryshuar të huasë për projektin e zhvillimit të rretheve verilindore (NO.347-AL), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe “Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD), të datës 5 shkurt 1999, të transferohen, në formën e grantit, në Fondin e financimit pr zonat malore, sipas marrëveshjes që do të lidhet për qkëtë qëllim ndërmjet Ministrisë së Financave dhe këtij fondi.

4.Fondet e huave, të mbetura në dispozicion sipas aneksit 2, akategoria 3, të marrëveshjes së ndryshuar të huasë për projektin e vadtjes në shkallë të vogël (NO372-AL), ndërmjet Republikë së Shqipërisë dhe “Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë”, (IFAD), më datën 5 shkurt 1999, t transferohen, në formë granti, në “Fondin e financimit për zonat malore:, sipas marrëveshjes që do të lidhet për këtë qëllim ndërmjet Ministrisë së Fionancave dhe këtij fondi.

5.Transferimi faktik i huave dhe i aseteve, në të gjitha rastet e mësipërme, të bëhet vetëm pas vlerësimit të tyre nga një kontroll financiar, i pavarur.

6.Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta